



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Dragash
Opština Dragaš
Municipality Dragas

-Kuvendi Komunal

01. Nr.06-6355/4

Dt.28.04.2016

D r a g a s h

Në bazë të nenit 13. dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 2.3. dhe 4. të Ligjit për Eksproprium të Pronës së Paluajtëshme (Ligji 03/L-139) dhe neneve 32.2. dhe 57 të Statutit të Komunës Dragash, Kërkesës së N P N -SH.P.K „RENELUAL TAHIRI“ nga Prizreni 01 Nr.463-5568 të dt.08.04.2016, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e mbajtur të dt.28.04.2016, miraton këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET** shqyrtimi i mëtejshëm i Kërkesës për eksproprium për qëllime të interesit publik të sipërfaqeve të pronave të parcelave-pjesëve të paluajtëshme private për ndërtimin e dy mini-hirocentraleve dhe atë në HC“ORÇUSHA” me kapacitet 4MW dhe HC“DRAGASH” me kapacitet 3,4MW. ,që si parcela janë të përcaktuara për përfshirje në Projektin si qëndron në Tabelën, në vijim.
- II. Vlerësimi i pronës do të bëhet nga ana e Shërbimit Pronëso- Juridik të Komunës së Dragashit në harmoni me nenin 15 të ligjit të lartpërmendur dhe Udhëzimin Administrativ MF-Nr.02/2015 për lejimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për llogaritje të shumës së kompenzimit për pronë të paluajtëshme e cila është objekt e ekspropriumit dhe dëmeve që i përkasin ekspropriumit.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Shërbimi Pronëso- Juridik (DUGJMM) dhe Drejtorati i Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe Inspektionit i Komunës- Dragash, kurse kompenzimin për eksproprium e siguron investuesi NPN-SHPK „Renelual Tahiri“-Prizren.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së dhe publikim në web-faqen zyrtare të Komunës-Dragash.

Shtojcë: Kërkesa e NPN-SHPK „Renelual Tahiri“-Prizren dhe Tabelat e ekspropriumit...

I dërgohet:

- MAPL-së (Zyrës Ligjore)-Prishtinë,
- Kryetarit të Komunës-Dragash,
- Drejtoratit të Urbanizmit, Gjeodezisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit-Dragash,
- Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Inspektion-Dragash, dhe
- Arkivit



Kuvendi Komunal-Dragash

Kryesuesi
Shaban Shabani